



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kualitetu, standardima i uspjehu

Raport përmbledhës i rezultateve të vlerësimit nga pyetëtori
“Studenti Administratën”

Semestri veror 2024/2025

Qëllimi i vlerësimit

Përmes pyetësorit “Studenti Administratën”, studentët kanë mundësinë të vlerësojnë komunikimin me administratë, sjelljen, gatishmërinë për t’i këshilluar, disponueshmërinë në kohën kur atyre ju nevojitet, dhe përmbushjen e kërkesave të tyre. Qëllimi i vlerësimit të administratës nga studentët është të ndihmojë universitetin në identifikimin e çështjeve dhe sfidave në shërbimin ndaj studentëve, dhe në përmirësimin e proceseve dhe politikave për t’u përshtatur më mirë me nevojat e studentëve.

Metodologjia e punës

Ashtu siç është e paraparë në Kalendarin e aktiviteteve të Udhëzuesit për sigurim të cilësisë, në fund të secilit semestër, studentët plotësojnë pyetësorin “Studenti – Administratën”, për të vlerësuar shërbimet administrative të universitetit. Pyetësori është përbërë nga 3 pyetje me mundësi të përgjigjes në shkallë nga 1 deri në 5 (1* dobët, 2* mjaftueshëm, 3* mirë, 4* shumë mirë, 5* shkëlqyeshëm), për zyrët apo shërbimet që studenti merr apo pranon nga administrata. 3 pyetje me përgjigje alternative dhe në fund fare studentët kanë pasur mundësinë të shprehën lirshëm duke dhënë sugjerime dhe vërejtje për shërbimet e ofruara nga administrata.

Procesi i vlerësimit

Pyetësori “Studenti – Administratën”, është shpërndarë përmes sistemit elektronik SEVC. Procesi i vlerësimit në të pesë njësitë akademike, për semestrin veror 2024/2025, është realizuar gjatë periudhës së paraqitjes së provimeve, duke filluar me datë 23 maj dhe ka zgjatë deri me 07 qershor, dhe janë plotësuar gjithsej 1036 pyetësorë.

Me fillimin e procesit të vlerësimit, studentët janë njoftuar me rregullat e përgjithshme të këtij procesi, duke i garantuar ata se pyetësorët janë anonim dhe se ata mund të shprehin lirshëm atë që mendojnë për shërbimet administrative. Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, të dhënat janë mbledhur dhe përpunuar nga Zyra qendrore për sigurim të cilësisë dhe vlerësim në nivel universiteti, si dhe nga Koordinatorët/Zyrtarët e cilësisë për njësi akademike. Raportet përmbledhëse janë analizuar nga Komisionet për Sigurim të Cilësisë në nivel të njësive akademike dhe nga Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim në nivel qendror. Bazuar në gjetjet nga rezultatet e vlerësimit, janë dhënë rekomandimet për përmirësim.

Rezultatet e vlerësimit

1. **Si preferojnë studentët të komunikojnë me administratë,** tregojnë rezultatet si në vijim: 550 studentë preferojnë të komunikojnë fizikisht me administratën, çka tregon se takimi i drejtpërdrejtë vazhdon të shihet si mënyra më e besueshme dhe më e sigurt për zgjidhjen e çështjeve administrative. 432 studentë kanë zgjedhur e-mailin, që tregon një prirje në rritje drejt përdorimit të kanaleve digjitale. 56 studentë kanë preferuar telefonin, duke reflektuar se ky kanal përdoret më pak, ndoshta për shkak të mungesës së formalitetit dhe vështirësisë për të pasur dëshmi të komunikimit.




Figura 1

2. **A punon biblioteka me orar të përshtatshëm,** studentët kanë vlerësuar si në vijim: 828 studentë mendojnë se biblioteka punon me orar të përshtatshëm për studentë. Kjo tregon një nivel të lartë përputhje të orarit me nevojat e tyre. Vetëm 49 studentë kanë vlerësuar se orari nuk është i përshtatshëm. 161 studentë nuk e frekuentojnë bibliotekën, që është një numër i konsiderueshëm (më shumë se sa ata që janë të pakënaqur me orarin). Ky grup tregon se një pjesë e studentëve nuk e përdorin fare shërbimin, ndoshta për arsye alternative si materiale online, mësim jashtë fakultetit apo mungesë kohe.




Figura 2

3. **Nga kush informoheni për të drejtat e juaja dhe shërbimet studentore?** Rezultatet tregojnë se shumica, 704 studentë janë informuar për të drejtat dhe shërbimet studentore përmes Zyrtarëve për çështje studentore (referentëve), ndërsa një numër më i vogël, 334 kanë marrë këto informacione nga Sekretari i njësive akademike. Kjo tregon se në praktikë, roli kryesor në komunikimin me studentët i takon referentëve, ndërsa sekretarët mbeten gjithashtu një pikë e rëndësishme kontakti, por më pak e përdorur.




Figura 3

4. **A është korrekt dhe profesional komunikimi me zyrtarët e administratës, studentët kanë vlerësuar si në vijim:**

Vlerësimi për Sekretarët e njësive akademike: 573 studentë e vlerësojnë komunikimin si shumë korrekt dhe profesional me “shkëlqyeshëm”, 161 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, ndërsa 210 me “mirë”, çka është një tregues pozitiv për performancën e sekretarëve të njësive akademike. Një numër i konsiderueshëm ka dhënë vlerësime të ulëta: 98 studentë kanë vlerësuar si “mjaftueshëm” 173 studentë kanë vlerësuar si “dobët”. Kjo tregon se, ekziston një pjesë jo e vogël e studentëve që nuk janë plotësisht të kënaqur me cilësinë e komunikimit, gjë që nënkupton nevojën për përmirësim të mëtejshëm në ofrimin e shërbimit administrativ (figura 4).




Figura 4

Vlerësimi për Zyrtarët për Çështje Studentore (Referentët): Nga analiza e rezultateve të pyetjes “A është korrekt dhe profesional komunikimi me zyrtarët për çështje studentore (referentët)?”, përgjigjet janë dhënë si në vijim: 555 studentë kanë dhënë vlerësimin më të lartë “shkëlqyeshëm”, duke reflektuar një përvojë shumë pozitive dhe të kënaqshme në komunikimin me referentët. 164 studentë e kanë vlerësuar komunikimin si “shumë të mirë”, duke konfirmuar që një pjesë e konsiderueshme e studentëve e perceptojnë këtë marrëdhënie në mënyrë pozitive. 205 studentë kanë dhënë vlerësime si “mirë”, që tregon se përvoja e tyre është as shumë pozitive, as shumë negative. 101 studentë kanë dhënë vlerësim “mjaftueshëm”, ndërsa 154 studentë kanë dhënë vlerësim “dobët”, duke treguar se një grup i caktuar nuk janë të kënaqur me korrektësinë dhe profesionalizmin e komunikimit. Mesatarja e përgjithshme e vlerësimit është 3.73, mbi nivelin mesatar, duke dëshmuar një tendencë pozitive, por jo maksimale (figura 5).




Figura 5

Vlerësimi për Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit – IT: Në përgjithësi, komunikimi me Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit – IT shihet si i mirë dhe korrekt. 610 studentë kanë vlerësuar “shkëlqyeshëm”, 162 studentë e kanë vlerësuar me “shumë mirë”, duke treguar një perceptim pozitiv. 186 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, që tregon një kënaqësi mesatare dhe perceptim të qëndrueshëm të komunikimit. Nga ana tjetër, 97 studentë kanë dhënë vlerësimin “mjaftueshëm” dhe 139 studentë kanë dhënë vlerësimin “dobët”, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme e studentëve nuk kanë pasur një përvojë plotësisht të kënaqshme me komunikimin me IT-në. Kjo tregon nevojën për përmirësim në disa aspekte të shërbimit. Mesatarja 3.84 reflekton se, megjithëse ka disa shqetësime, perceptimi i përgjithshëm mbetet pozitiv dhe komunikimi konsiderohet kryesisht korrekt dhe profesional (figura 6).




Figura 6

Vlerësimi për Zyrtarët për Zhvillim të Karrierës: Rezultatet e vlerësimit të komunikimit me zyrtarët për Zhvillim të Karrierës tregojnë një perceptim kryesisht pozitiv nga studentët. Numri më i madh i studentëve, 552, e ka vlerësuar komunikimin si “shkëlqyeshëm”, duke treguar një nivel të lartë profesionalizmi dhe korrektësie. Një grup i konsiderueshëm, 172 studentë, e ka vlerësuar si “shumë mirë”, ndërsa 213 studentë e kanë vlerësuar si “mirë”, që konfirmon se përvoja e shumicës së studentëve me këta zyrtarë është pozitive. Nga ana tjetër, 99 studentë e kanë vlerësuar komunikimin si “mjaftueshëm” dhe 137 si “dobët”, duke treguar se një pjesë e vogël e studentëve përjeton vështirësi ose ka pritshmëri më të larta nga komunikimi me zyrtarët. Vlera mesatare prej 3.77 reflekton një perceptim mbi mesataren dhe tregon se, në përgjithësi, zyrtarët për Zhvillim të Karrierës ofrojnë një komunikim të suksesshëm dhe profesional, me hapësirë për përmirësim në aspektet që ndikojnë tek pakënaqësia e një grupi të vogël studentësh (figura 7).




Figura 7

Vlerësimi për Zyrtarët e Protokolit dhe Arkivës: Bazuar në vlerësimet e studentëve për komunikimin me Zyrtarët e Protokolit dhe Arkivës, rezultatet janë si në vijim: 555 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, duke treguar se shumica e studentëve e konsiderojnë komunikimin me zyrtarët korrekt dhe profesional. 173 studentë “shumë mirë”, duke konfirmuar se janë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve të stafit. 199 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, që tregon një nivel të mirë të komunikimit, edhe pse jo gjithmonë në nivelin më të lartë. 96 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 142 studentë kanë vlerësuar me “dobët”, ku duket se një pjesë e konsiderueshme kanë qenë të pakënaqur me komunikimin me Zyrtarët e Protokolit dhe Arkivës. Ky grup tregon se, pavarësisht perceptimit kryesisht pozitiv të shumicës, ka raste specifike ku komunikimi mund të përmirësohet. Mesatarja prej 3.78 tregon një perceptim të përgjithshëm pozitiv, por gjithashtu tregon se ka mundësi për të përmirësuar disa aspekte të komunikimit për të arritur një standard më të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës (figura 8).




Figura 8

Vlerësimi për Zyrtarët e Bibliotekës: Shumica e studentëve kanë vlerësuar komunikimin me zyrtarët e bibliotekës si shumë pozitiv. 594 studentë e kanë konsideruar “shkëlqyeshëm”, ndërsa 159 si “shumë mirë”, duke reflektuar një nivel të lartë profesionalizmi dhe korrektësie. 179 studentë e kanë vlerësuar si “mirë” dhe 106 si “mjaftueshëm”, duke treguar disa përvoja më pak të kënaqshme. 147 studentë e kanë vlerësuar komunikimin si “dobët”, që nënkupton nevojën për përmirësime në disa raste. Në përgjithësi, përvoja e studentëve është kryesisht pozitive, me një numër të vogël që tregon mundësi për rritje të cilësisë së shërbimit (figura 9).




Figura 9

5. Niveli i përmbushjes së kërkesave të studentëve nga zyrat përkatëse është:

Vlerësimi për Sekretarët e njësive akademike: Sipas rezultateve, 559 studentë e kanë vlerësuar punën e sekretarit të njësive akademike si “shkëlqyeshëm”, duke treguar efikasitet dhe gatishmëri për të përmbushur kërkesat e studentëve. Një numër i konsiderueshëm, 151 studentë, e kanë vlerësuar si “shumë mirë”, duke reflektuar një kënaqësi të përgjithshme me shërbimin. 203 studentë kanë dhënë vlerësimin “mirë”, duke treguar se përvoja e tyre është kryesisht pozitive, por ka fusha që mund të përmirësohen. 114 studentë e kanë vlerësuar si “mjaftueshëm”, duke sugjeruar se në disa raste shërbimi nuk ka qenë plotësisht i kënaqshëm. Në fund, 147 studentë kanë dhënë vlerësimin më të ulët “dobët”, duke treguar se një pjesë e studentëve nuk kanë qenë fare të kënaqur në përmbushjen e kërkesave. Mesatarja prej 3.73 reflekton një performancë të përgjithshme të mirë, me një shumicë të studentëve të kënaqur, por ekziston hapësirë për përmirësim në mënyrë që të arrihet një nivel edhe më i lartë i kënaqësisë (figura 10).




Figura 10

Vlerësimi për Zyrarët për Çështje Studentore (Referentët): 558 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, duke treguar se përvoja e tyre ka qenë shumë profesionale dhe e kënaqshme. 173 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, ndërsa 193 e kanë vlerësuar si “mirë”, duke reflektuar një kënaqësi të lartë, por me disa mundësi për përmirësim në disa detaje të shërbimit. Një pjesë më e vogël, 116 studentë, kanë dhënë vlerësimin “mjaftueshëm”, ndërsa 135 e kanë vlerësuar si “dobët”, duke sinjalizuar se disa studentë kanë hasur vështirësi ose nuk janë ndjerë të mbështetur siç pritej. Mesatarja 3.77 tregon që perceptimi i përgjithshëm është pozitiv, por rezultatet gjithashtu nënvizojnë nevojën për përmirësime në disa fusha, në mënyrë që të sigurohet që çdo student të ketë një përvojë të qëndrueshme, të plotë dhe të kënaqshme me referentët (figura 11).




Figura 11

Vlerësimi për Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit – IT: 588 studentë e kanë vlerësuar punën e zyrtarëve të IT-së me “shkëlqyeshëm”, ndërsa 186 të tjerë me “shumë mirë”, çka tregon nivel të lartë profesionalizmi dhe përkushtimi. Një numër i konsiderueshëm, 179 studentë kanë dhënë notën “mirë”, duke treguar kënaqësi të përgjithshme por edhe vend për përmirësim. 97 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 137 studentë kanë dhënë vlerësimin “dobët”, që tregon ekzistencën e pakënaqësive të caktuara. Mesatarja e përgjithshme 3.83 dëshmon për një performancë shumë të mirë, por sugjeron nevojën për të adresuar më mirë rastet e studentëve që nuk janë plotësisht të kënaqur (figura 12).




Figura 12

Vlerësimi për Zyrtarët për Zhvillim të Karrierës: Shumica e studentëve, 550 prej tyre, kanë vlerësuar zyrtarët për zhvillim të karrierës me “shkëlqyeshëm”, ndërsa 189 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë” dhe 196 me “mirë”, çka tregon një nivel të lartë kënaqësie. Një numër më i vogël, 102 studentë, kanë dhënë vlerësimin “mjaftueshëm”, ndërsa 138 i kanë vlerësuar “dobët”, duke sinjalizuar nevojën për përmirësime në disa aspekte. Mesatarja prej 3.78 e konfirmon se shërbimi perceptohet përgjithësisht në nivel të mirë (figura 13).




Figura 13

Vlerësimi për Zyrtarët e Protokolit dhe Arkivës: 572 studentë kanë vlerësuar si “shkëlqyeshëm”, që është edhe numri më i madh i përgjigjeve. 170 studentë kanë dhënë vlerësimin “shumë mirë”, duke treguar gjithashtu kënaqësi të lartë me shërbimin. 201 studentë kanë zgjedhur vlerësimin “mirë”, që tregon një përmbushje të pranueshme të kërkesave. 87 studentë kanë vlerësuar “mjaftueshëm”, duke lënë të kuptohet se shërbimi nuk ka qenë në nivelin e pritur. 139 studentë kanë dhënë vlerësimin “dobët”, të cilët nuk kanë qenë fare të kënaqur. Mesatarja e përgjithshme prej 3.81 dëshmon se shërbimi i ofruar nga këta zyrtarë perceptohet kryesisht në nivel shumë të mirë deri shkëlqyeshëm, edhe pse një numër jo i vogël studentësh kanë pasur përvoja më pak të kënaqshme (figura14).




Figura 14

Vlerësimi për Zyrtarët e Bibliotekës: Shumica e studentëve, rreth 591 kanë vlerësuar shërbimin e zyrtarëve të bibliotekës si “shkëlqyeshëm”, çka tregon nivel të lartë kënaqësie. 158 studentë e kanë cilësuar si “shumë mirë”, ndërsa 174 studentë kanë vlerësuar si “mirë”, duke reflektuar se shërbimi shihet përgjithësisht pozitiv dhe funksional. Megjithatë, një pjesë më e vogël e studentëve, 111 me vlerësimin “mjaftueshëm” dhe 139 me “dobët”, tregojnë se ekzistojnë ende hapësira për përmirësim, sidomos në disa elemente të komunikimit apo përmbushjes së kërkesave. Mesatarja (3.81) dëshmon një prirje të përgjithshme pozitive dhe dominim të vlerësimeve shumë të larta (figura 15).




Figura 15

6. Përgjigjet në kërkesat e studentëve a merren parasysh me kohë nga:

Vlerësimi për Sekretarët e njësive akademike: 556 studentë kanë vlerësuar shërbimin e Sekretarit të njësisë akademike si “shkëlqyeshëm”, duke treguar se përgjigjet ndaj kërkesave jepen në kohë dhe me efikasitet të lartë. Një pjesë tjetër e konsiderueshme e studentëve, 160 kanë vlerësuar si “shumë mirë” dhe 191 kanë vlerësuar “mirë”, që tregon kënaqësi të përgjithshme, edhe pse disa aspekte mund të përmirësohen për të arritur standardin maksimal. Ndërsa, 107 studentë e kanë vlerësuar shërbimin si “mjaftueshëm”, duke treguar se ka raste kur përgjigjet nuk janë të menjëhershme ose të plota. 148 studentë e kanë vlerësuar si “dobët”, që reflekton se disa kërkesa nuk janë trajtuar në kohë ose ka pasur mangësi në komunikim. Kjo tregon se, edhe pse shumica është e kënaqur, ka nevojë për përmirësime të dukshme për të garantuar që të gjithë studentët të marrin shërbim të shpejtë, të plotë dhe të besueshëm (figura 16).




Figura 16

Vlerësimi për Zyrtarët për Çështje Studentore (Referentët): 542 studentë e kanë vlerësuar si “shkëlqyeshëm”, duke treguar besim dhe kënaqësi të lartë, ndërsa 166 studentë e kanë konsideruar shërbimin “shumë mirë”, që tregon një performancë të qëndrueshme dhe profesionale. 215 studentë e kanë vlerësuar si “mirë”, duke treguar se shërbimi është i pranueshëm, por ka vend për përmirësim. 102 studentë e kanë vlerësuar si “mjaftueshëm”, duke sinjalizuar disa mangësi në përmbushjen e pritshmërive, ndërsa 134 studentë e kanë cilësuar si “dobët”, që tregon raste ku ka pasur vonesa ose trajtim jo të plotë të kërkesave. Mesatarja 3.76 reflekton një kënaqësi të përgjithshme të lartë, megjithatë grupi që ka dhënë vlerësime më të ulëta tregon nevojën për përmirësim në menaxhimin dhe komunikimin me studentët (figura 17).




Figura 17

Vlerësimi për Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit – IT: 573 studentë kanë vlerësuar “shkëlqyeshëm”, 170 të tjerë e kanë vlerësuar si “shumë mirë”, ndërsa 199 si “mirë”. Kjo tregon se IT-ja përgjigjet me kohë dhe në mënyrë të kënaqshme për shumicën e studentëve. Nga ana tjetër, një pjesë më e vogël, 127 studentë e kanë vlerësuar shërbimin si “dobët” dhe 97 si “mjaftueshëm”, çka tregon se ende ekziston hapësirë për përmirësim në disa raste. Mesatarja e përgjithshme 3.83 tregon se shërbimi i IT-së funksionon mirë, por ka mundësi për rritje të cilësisë, sidomos për grupin më të pakënaqur (figura 18).




Figura 18

Vlerësimi për Zyrtarët për Zhvillim të Karrierës: Studentët janë shprehur të kënaqur ndaj punës së zyrtarëve për zhvillim të karrierës, ku numri më i madh, 547 studentë, e kanë vlerësuar shërbimin si “shkëlqyeshëm”. Pas tyre, 175 studentë janë shprehur se përgjigjet merren parasysh “shumë mirë”, ndërsa 205 të tjerë kanë dhënë vlerësimin “mirë”. Një grup më i vogël, prej 96 studentësh, e kanë cilësuar këtë proces si “mjaftueshëm”, ndërsa 137 studentë kanë dhënë vlerësimin “dobët”. Këto rezultate tregojnë një prirje të qartë pozitive, duke e vendosur nivelin e përgjithshëm të kënaqësisë në një mesatare të lartë prej 3.78 (figura 19).




Figura 19

Vlerësimi për Zyrtarët e Protokolit dhe Arkivës: 549 studentë e kanë vlerësuar shërbimin si “shkëlqyeshëm”, ndërsa 175 si “shumë mirë”, duke treguar se shumica e studentëve janë të kënaqur me kohën dhe cilësinë e përgjigjeve. Një pjesë tjetër, 199 kanë dhënë vlerësimin “mirë”, ndërsa 105 “mjaftueshëm” dhe 128 “dobët”, duke sinjalizuar nevojën për përmirësim në disa raste. Me një mesatare prej 3.79, shërbimi shihet përgjithësisht pozitiv, megjithatë mbetet vend për avancim të mëtejshëm (figura 20).




Figura 20

Vlerësimi për Zyrtarët e Bibliotekës: Shumica e studentëve, 576 e kanë vlerësuar shërbimin e bibliotekës si “shkëlqyeshëm”, ndërsa 153 si “shumë mirë” dhe 175 si “mirë”, duke treguar një kënaqësi të lartë të përgjithshme. Megjithatë, 116 studentë janë shprehur se shërbimi është vetëm “mjaftueshëm”, dhe 132 e kanë cilësuar “dobët”, duke sinjalizuar hapësirë për përmirësim. Nota mesatare prej 3.8 dëshmon një performancë pozitive të bibliotekës në raport me pritshmëritë e studentëve (figura 21).




Figura 21

REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM NGA KËSHILLI PËR MENAXHIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM

- Rekomandohet që personeli administrativ të përdorë sa më shumë komunikimin me e-mail, krahas shërbimeve që ipen fizikisht.
Afati i implementimit: I menjëhershëm!
- Nga sistemi i informacionit kërkohet që sa më shpejtë të përfshihet edhe komunikimi i drejtpërdrejtë online (chat i studentit me administratë).
Afati i implementimit: semestri veror 2026!
- Rekomandohen sekretarët e njësive akademike që të shtojnë mundësitë e komunikimit me studentët sipas kërkesës së studentëve.
Afati i implementimit: E menjëhershme.
- Rekomandohet Zyra e Burimeve Njerëzore që të organizojë trajnime për zyrtarët për çështje studentore mbi komunikimin profesional dhe orientimin ndaj studentit.
Afati i implementimit: maj 2026
- Rekomandohet Sekretari i Përgjithshëm që të standardizojë protokollet e komunikimit.
Afati i implementimit: shkurt 2026
- Rekomandohet IT që të krijojë një platformë për raportimin e problemeve teknike.
Afati i implementimit: shkurt 2026
- Rekomandohet Zyra për Zhvillim të Karrierës që të krijojë një orar të prezencës në fakultete të ndryshme, me kërkesë që në secilin fakultet të jenë prezent së paku dy herë në muaj, së paku nga katër orë në ditë.
Afati i implementimit: Nga 16 shkurti 2026 e tutje.
- Rekomandohet Zyra e Protokolit dhe Arkivës që të digjitalizojë procesin e protokolimit.
Afati i implementimit: shtator 2026
- Rekomandohet Biblioteka e Universitetit që të zhvillojë dhe ofrojë shërbime digjitale për studentët.
Afati i implementimit: shtator 2026